



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 315 prot.

Tiranë, më 21.02.2019

**VENDIM**

**Nr.13, datë 21.02.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 11, DATË 09.03.2018, NË**  
**INSTITUCIONIN E BASHKISË GJIROKASTËR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Hetimit Administrativ Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 11, datë 09.03.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Gjirokastrë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

**KONSTATOVA SE:**

Bazuar në Urdhrin nr. 75 (749 prot.), datë 03/10/2018, “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin embikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 11, datë 09.03.2018, të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Gjirokastrë.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 2, datë 13.01.2017, nëpërmjet Vendimit nr. 216, datë 25.10.2017, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Gjirokastrë dhe në Bashkinë Dropull”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Gjirokastrë.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Gjirokastrë raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues me nr. 11, datë 09.03.2018, për rregullimin e ligjshmërisë, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 60 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport dhe në detyrat e lëna për Bashkinë Gjirokastrë, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar në subjekt veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

- Në vendimin paralajmërues, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë që të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*

Nga aktet e administruara në subjekt nga grupi i punës, vërej se këto pozicione janë shpallur të lira me aktin nr.3075 prot., datë 08.05.18 dhe më pas ka vijuar puna me zhvillimin e procedurave të konkurrimit në përputhje me ligjin për shërbimin civil. Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Kreun III të Vendimit nr.242, datë 18.03.15, të Këshillit të Ministrave, *“Përplotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, pas procedurës së konkurrimit punonjësit:

1. \*\*\*\*\* është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin *“Specialist i Integritimit në BE”* me aktin nr. 2734/1 prot., datë 20.06.2018.
2. \*\*\*\*\* është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin *“Specialist i Integritimit në BE”* me aktin nr. 2734/2 prot., datë 20.06.2018.

- Në pikën 3 të vendimit paralajmërues është lënë detyrë ndryshimi i aktit administrativ nr. 1576, datë 29.05.2014, për deklarimin e statusit të punësimit nga nëpunës civil, në nëpunës civil në periudhë prove për nëpunësin \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Punëve Publike Administrimit dhe Kontrollit të Territorit*”. Të administrohet në dosjen e personelit vlerësimi i punës për periudhën e provës, mendimi me shkrim nga nëpunësi më i vjetër dhe eprori direkt të nxjerrë vendimin e arsyetuar për konfirmimin e tij. Më pas, njësia përgjegjëse të bëjë deklarimin si nëpunës civil në pozicionin e drejtorit.

Konstatohet se nga ana e njësisë përgjegjëse dhe nëpunësve përgjegjës janë ndërmarrë hapat për formalizimin e veprimeve, deri në nxjerrjen e aktit të deklarimit për nëpunësin në fjalë. Nëpunësi \*\*\*\*\* , me aktin nr. 6123 prot., datë 19.09.2018, është emëruar nëpunës civil në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Punëve Publike Administrimit dhe Kontrollit të Territorit*”.

- Në pikën 4 të vendimit paralajmërues i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara nga ligji.

Pas shqyrtimit të akteve të administruara nga grupi i punës, vërejt se, njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara nga ligji, kanë kryer veprimet për hartimin e përshkrimeve të punës për çdo nëpunës civil dhe një kopje e tyre e nënshkruar është bërë pjesë e dosjes së personelit për çdo punonjës.

- Në pikën 5 të vendimit paralajmërues i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që struktura administrative e bashkisë, të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke bërë saktësimin e pozicioneve të cilët kanë karakteristikat e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të përfshira në strukturën aktuale, duke ndjekur orientimet e lëna në vendimin e paralajmërimit të Komisionerit.

Me urdhrin nr.100, datë 16.03.2018, “*Për një ndryshim në Urdhrin nr. 3, datë 08.01.18, “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 31 datë 16.02.17, “Për miratimin e strukturës Organizative të Bashkisë Gjirokasër*” njësia përgjegjëse ka bërë një ndarje të drejtë dhe të qartë e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga pozicionet e punës që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Në pikën 6 të vendimit paralajmërues i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të plotësojë të gjitha mangësitë e konstatuara në dosjet e personelit të evidentuara në anekset bashkëlidhur raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Njësia përgjegjëse i ka plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara në dosjet e personelit që ishin bërë prezent në anekset bashkëlidhur raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke vlerësuar punën e njësive përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 11, datë 09.03.2018, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Gjirokastrë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësive përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Gjirokastrë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.11, datë 09.03.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Gjirokastrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**